



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16837/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtari Ali Latifi me pjesmarrjen e procesmbajtës Shemsije Lumi, sekretare juridike duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Arta Hajrizi nga Prishtina për kundërvajtje nga neni 16.paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarativin e prejardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, të LMK-së me dt. 20.10.2010, merrë këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Arta Muharrem Rama Hajrizi e lindur me 28.08.1979 në Mitrovicë tani me vendbanim në Prishtinë rr “Bregu Diellit” Zona Lindjës Q-9 nr 18, juriste Ministria e Punëve të Jashme konzuli i përgjithshëm Nju-Jork, e martuar, deri më tani thot e pa denuar.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse me dt.22.03.2010, si zyrtar i lartë publik është punësuar në Ministrin e Punëve të Jashme të Republikës së Kosovës, dhe nga Agjensioni për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për deklarimin e pasuris edhe pse i jan dërguar formularët e Agjensionit për antikorrupsion, në formë fizike dhe elektronike. Me ç,ka ka kryer kundërvajtje nga neni 16.paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, andaj për këtë

G J O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 300 (Treqind) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë në favor të AFQ-së në xhir.1000-4300-70000-518, e nëse nuk e paguan në afatin e paraparë e njëjta do të ekzekutohet me denim burgu në kohëgjatje 18 (Tetëmdhjet) ditësh, duke ia llogarit nga **15 €** në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushallit është i obliguar të paguaj shumën prej **5 €** në afat dhe gjirollogari të nejtë me gjobën.

Pagesa e gjobës dhe paushallit gjyqsor mund të bëhet në çdo bankë, ndërsa një kopje të kthehet në Gjykatë.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dërguar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjensioni Kundër korrupsionit në Prishtinë, ka ushtruar kërkesën nr.01-2273/10 të dt. 08.06.2010, për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartpërmendurit dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

E pandehura Arta Muharrem Rama Hajrizi me dt. 13.10.2010, deklaroi, se unë kam qenë në marrdhanje pune në Ministrin e Jashtme të Republikës së Kosovës, në SHBA.

Me dt. 23. Mars 2010, kam marrë formularin nga Agjensioni kundërkorrupsion në vendin e punës ku punoj.

Me dt. 31. Mars 2010, në ora 14.54 min, me faks e kam dërguar materialin e plotësuar në Ministrin për punë të Jashtme në Republikën e Kosovës dhe kte e ka pranuar administrata e Ministris së Punëve të Jashme Afërdita Zeqiri por e njëjta nuk e ka dorzuar këtë material në Agjension kundër korrupsionit është fakt se raporti tim e ka kërkuar Agjensoni kundër korrupsionit por këtë raport ky agjension nuk e ka poseduar pasi që shërbimi i administratës së ministris na ka udhëzuar që të gjitha të dërgohen në Ministri e pastaj të gjitha raportet ministria i dërgon në agjensionin për luftimin e kurrupsionit.

Gjykatës jap në shiqim një kopje të formularit të dërguar Ministris së punëve të jashme me dt. 31.03.2010. gjith

ashtu kësaj deklarate i, a bashkangjes edhe 17 shkresa zyrtare, që i kam dërguar Ministris së Punëve të Jashme në Kosovë dhe ky material nuk është dorzuar edhe pse unë këtë e konsideroj se obligimin tim e kam kryer me kohë. Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka marrë në pyetje ushtruesin e fletëparaqitjes me dt. 30.06.2010, i cili deklaroi, se të pandehurës i kemi dërguar materialin me dt. 23 mars 2010, dhe konfirmimi është bërë se pranimi është marrë në dy forma në ate fizike dhe në mes të CD-5, të formularëve përkatës dhe në të jan të precizuar se afati i fundit të dërgimit është dt 31 mars 2010. Andaj e pandehura nuk ka përmbush obligimet e saja ligjore sipas ligjit antikorrupsion dhe ka kryer kundërvajtje sipas kualifikimit juridik që kemi prezantuar në kërkesën tonë të iniciuar me dt. 08.06.2010, dhe kërkoj nga gjykata që e njëjta të shpallet fajtor sipas ligjit.

Me rastin e shqiptimit të denimit gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurës ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë lloj denimi do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit që e pandehura në të ardhmën t, iu shmangët kryerjes së veprave të tilla apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh prej ditës së pranimi të të njejtit nëpërmjet kësaj Gjykate pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË Me dt. 20.10.2010

GJYQTARI I KUNDËRVAJTJËS

Mr.Sc.Ali Latifi

